

Gykata Kushtetuese - Mjet ankimi efektiv sipas KEDNJ

I. Hyrje

Tema për të cilën më është kërkuar të jap disa konsiderata, pra, sigurimi i mjeteve efektive kombëtare të ankimit në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ-së, pa dyshim që është diskutuar shpesh nëpër auditore të ndryshme mes juristësh, por ka qenë dhe objekt debati, të brendshëm dhe të jashtëm për gjyqtarët dhe stafin e GJK-së, posacërisht në lidhje me efektivitetin e kësaj gjykate si mjet ankimi. Besoj që për pjesën më të madhe të të pranishmëve, është e qartë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (GJK) në drejtim të procesit të rregullt ligjor. Prandaj dhe unë shkurtimisht do fokusohem vetëm në ç'farë ka bërë GJK deri tani për t'ua konsideruar mjet ankimi efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së, dhe se si mund të përmirësohet veprimtaria e saj në të ardhmen.

Disa nga çështjet kryesore kundër Shqipërisë, të cilat kanë shënuar pikën e kthesës dhe të evolucionit në veprimtarinë e kësaj gjykate sa i përket gjykimit të kërkesave me objekt procesin e rregullt ligjor janë: (i) çështja *Qufaj & Co kundër Shqipërisë (2004)*, ku GjEDNJ u shpreh se sistemi ligjor shqiptar ofronte mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, mundësi kjo që teorikisht ishte në dispozicion të shoqërisë ankues, e cila u përpoq ta shfrytëzonte këtë mjet, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën e saj. Në këtë kuadër GjEDNJ vlerësoi se e drejta për një proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhej të ishte interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkeljet e pretenduara për mosrespektimin e kritereve të nenit 6/1 të Konventës. Kështu në opinionin e GjEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor. (prg 40-42); (ii) çështja *Gjonboçari kundër Shqipërisë (2007)*, ku GjEDNJ vërejti se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik, të cilin aplikanti mund ta kishte përdorur për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit; (iii) çështja *Marini kundër Shqipërisë, (2008)* ku GjEDNJ rikujton se në sistemin e brendshëm juridik nuk ka pasur mjete juridike efektive lidhur me tejzgjatjen e procesit. Sipas saj se edhe duke supozuar se Gjykata Kushtetuese do të mundej në teori të ofronte dëmshpërblimin e

duhur për pretendimet për kohëzgjatje të tepruar, pala shqiptare nuk mund të jepte ndonjë rast ku Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për një kohëzgjatje të tepruar të procesit. (...) Mungesa e praktikës tregon pasigurinë e një mjeti të tillë ligjor në praktikë. (prg 156).

II. Gjykata Kushtetuese “de facto”. Jurisprudenca dhe efektet e vendimeve me objekt procesin e rregullt ligjor

Në aspektin e procesit të rregullt ligjor Gjykata Kushtetuese ka kompetenca të kufizuara lidhur me të drejtën e saj për të shqyrtuar ankesat e individëve. Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një *proces të rregullt ligjor*, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave¹.

Neni 42 i Kushtetutës që i korrespondon (pjesërisht) nenit 6 të KEDNJ, sanksionon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një *proces të rregullt ligjor*. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

GJEDNJ ka theksuar se, edhe pse një praktikë gjyqësore që në pamje të parë nuk duket se përbën një mjet të efektshëm, mundet që me kalimin e kohës dhe akumulimin e jurisprudencës në fund të konsiderohet një mjet efektiv, që në parim duhet të ezaurohet². GjEDNJ ka vlerësuar gjithashtu se, përderisa nuk kishte asgjë në formulimin e nenit përkatës në Kushtetutë që do ta privonte veprimin e ankueses nga mundësia për të rezultuar i suksesshëm, ajo (ankimuesja) duhet të dorëzonte një kërkesë kushtetuese pavarësisht faktit që jurisprudenca e brendshme, doktrina ligjore dhe tradita e vështirësonin arritjen e një rezultati të suksesshëm³.

Në këtë kontekst, GJK ka patur parasysh se edhe pse jurisprudenca e saj deri në njëfarë periudhe mund të konsiderohej e tillë që vështirësonte aksesin e individit para kësaj gjykate në lidhje me procesin e rregullt ligjor në disa aspekte, ajo gjithsesi duhet të interpretonte në mënyrën

¹ Neni 131/f i Kushtetutës;

² Gorou kundër Greqisë, vendimi i 20 Mars 2009, prg. 32 dhe 34

³ D. kundër Irlandës, nr. 26499/02, prg. 102

më të zgjeruar të mundshme, legjitimimin e individit sipas nenit 131/f të Kushtetutës për t'iu drejtuar gjykatës. Ky akses i duhej dhënë individit për sa kohë që dispozitat kushtetuese nuk kishin asnjë pengesë dhe jurisprudenca duhet të ishte në përputhje me vendimmarrjen e GJEDNJ, sa i përket pozicionit të GJK si një mjet ankimi efektiv kombëtar.

Konkretisht GJK në çështjen me kërkues **A. Koliqi** (2012) ka vlerësuar se mund të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë edhe kërkesat e individëve, për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre mund të mos ketë përfunduar në të gjitha shkallët e gjyqësorit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, në të tilla raste individit duhet t'i drejtohet Gjykatës, sepse nuk ka mjete të tjera efektive në dispozicion për ta përshpejtuar procesin⁴.

Ndërsa në çështjen me kërkues **O.Shyti** (2011) ajo ka pranuar se: "... kompleksiteti i çështjes, sjellja e organit procedues dhe e kërkuesit janë bërë shkak për zgjatjen e procesit gjyqësor tej afateve të arsyeshme. Pavarësisht se vonesat, që i atribuohen organit procedues, kanë ndodhur për shkaqe objektive dhe hapësirat legjislative kanë lejuar rishqyrtimin e çështjes, në çmuarjen e Gjykatës, zvarritja e procesit nga autoritetet shtetërore është e pajustificueshme. Edhe pse në kushtet e mungesës së një mjeti juridik specifik për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga mosrespektimi i standardit kushtetues të afatit të arsyeshëm, Gjykata thekson se është detyrë e autoriteteve kompetente, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë si dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të marrin masat për të siguruar mirëadministrimin e proceseve gjyqësore dhe mënjanimin e shtyrjeve të tyre tej afateve të arsyeshme." (prg.13) Në këtë çështje GJK thekson se nuk ka mjet juridik të posaçëm për kompensim dëmi të shkaktuar nga mosrespektimi i standardit kushtetues të afatit të arsyeshëm, por gjithsesi kjo gjykatë ka konstatuar shkeljen⁵.

Për më tepër kjo gjykatë në çështjen me kërkues **K.Kryekurti**, (2011) ka pohuar se kur kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit, dhe kur karakteri i vendimit të ndërmjetëm e kërkon, si

⁴ V. nr.12/2012

⁵ V.nr.47/2011

përrjashtim, ai mund të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës, duke i hapur rrugë kontrollit kushtetues të kësaj kategorie vendimesh⁶.

Ndërsa në çështjen me kërkues **A.Xheraj**, (2011) GJK ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë me arsyetimin, se edhe pse sistemi penal shqiptar nuk e lejonte (nga pikëpamja formale) një rishikim të vendimeve penale përfundimtare nëpërmjet rihapjes së procesit, pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve serioze të procesit të drejtë, Gjykata e Lartë duhet të zbatonte drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në, duke rihapur proceset penale të përfunduara me vendim të formës së prerë, pas dhënies së një vendimi nga GJEDNJ⁷. Edhe pse mungonin dispozitat procedurale në KPP, për rihapje të proceseve pas vendimit të GJEDNJ, në rastet kur kjo e fundit kishte konstatuar shkelje të ligjit nga gjykatat, kjo nuk e pengoi GjK që me praktikën e saj të detyronte Gjykatën e Lartë të rimerre çështjen në shqyrtim.

Sa i përket çështjes me kërkues **E.Memishaj**, (2006) pak më e hershme, u desh vendimi Qufaj & Co, që të sillte ndryshime në jurisprudencën e kësaj gjykate, duke e konsideruar pjesë të procesit të rregullt ligjor ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, qëndrim tashmë i konsoliduar me disa vendime në vazhdimësi.

Të gjitha çështjet e larpërmendura tregojnë përfaqsimin e kësaj gjykate ndaj konsiderimit të shkeljeve konventore si shkelje kushtetuese, dhe rregullimit ligjor të situatës brenda kuadrit kombëtar. Megjithatë vendimet në lidhje me konstatimin e procesit të parregullt ligjor për shkak të moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, janë deklarative në kuptimin që ato edhe pse konstatojnë shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe i deklarojnë ato, nuk arrijnë të vendosin detyrime për organet e shtetit për ekzekutimin e këtyre vendimeve ashtu si nuk arrijnë t'i caktojnë dëmshpërblim individit ndaj të cilit është kryer shkelja. E njëjta gjë mund të thuhet për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit ligjor, ku përsëri GJK vetëm konstaton shkeljen dhe vendimi i saj është deklarativ.

Në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë (2009)*, GJEDNJ u shpreh se, çështja e shterrimit të mjeteve të brendshme ligjore është e lidhur ngushtë dhe kryesisht me çështjen e efektivitetit të ankimit kushtetues në lidhje me *moszbatimin e një vendimi përfundimtar* gjykate, i cili është

⁶ V. nr.28/2011

⁷ V. nr.20/2011

shqyrtuar sipas nenit 13. (prg 39). GjEDNJ verejti se vendimet e Gjykatës Kushtetuese njohën se ka shkelje të së drejtës së ankuesit për qasje në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave të brendshme. Gjithsesi konstatimet e tyre ishin deklaruese prandaj Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë ndreqje adeguate. Vecanërisht ajo nuk akordoi ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale dhe jo materiale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë për parandalimin e shkeljes të pretenduar ose vazhdueshmërinë e saj. (prg 58).

Duke pasur parasysh këtë qëndrim të GJEDNJ, GJK ka sugjeruar që në ndryshimet e ligjit organik të saj, të përfshihet dhe e drejta e kërkuesve, që për kohëzgjatje të procesit tej afateve të arsyeshme të kenë mundësi të ankohen në GjK edhe pa ezauruar të gjitha mjetet e ankimit edhe pse me jurisprudencën e vet interpretative tashmë e ka realizuar. Ky parashikim duhet të pasohet nga e drejta e GjK për të urdhëruar organin administrativ/gjykatën e zakonshme për përshpejtimin e procesit, pasi ka konstatuar arsyet e tejjzgjatjes dhe organin përgjegjes për shkeljen, si dhe dëmshpërblim ndaj individit. Po kështu GJK ka propozuar që në lidhje me pretendimin për tejjzgjatje të paarsyeshme të procesit, në mënyrë që sistemi vendas të jetë më efektiv dhe Gjykata Kushtetuese të mos mbingarkohet me çështje të kësaj natyre, mund të bëhen edhe parashikimet përkatëse në kodet e procedurave penale dhe civile, në mënyrë që individit para se t'í drejtohet Gjykatës Kushtetuese të ketë të drejtë të ankohet fillimisht në gjykatat e zakonshme.

III. Në vend të konkluzioneve

Parimi i subsidiaritetit kërkon që “mjeti efektiv ligjor” të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të individit të parashikuara në KEDNJ në nivel kombëtar. GJEDNJ ka theksuar se paraqitja e ankesave në gjykatë, konform kritereve të parashikuara nga legjisllacioni i brendshëm duhet të bëhet para organit të duhur vendas, por kjo nuk kërkon që çështja të adresohet me anë të mjeteve që nuk janë të përshtatshme dhe efektive.

De facto Gjykata Kushtetuese mbetet një mjet ankimi jo efektiv lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike, si dhe me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedimeve si elementë të procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, ndërsa në elementët e tjerë të tij, GJK shfuqizon vendimin e

gjykatave të zakonshme (dhe jo konstaton), çështja rikthehet për rigjykim, duke ofruar ndreqje të pasojave dhe korrigjim të shkeljes brenda sistemit ligjor shqiptar.

Sipas Rekomandimit nr.6/2004 “Për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit”, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t’u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ. Modifikimi i së drejtës së brendshme nënkupton edhe krijimin e një jurisprudence të re apo evoluimin e saj në këndvështrim të standardeve të Strasburgut dhe parimeve të shtetit të së drejtës, me qëllim dhënien e një drejtësie sa më efektive, e zbërthyer edhe në ekonomi të termave kohore apo financiarë për individët shqiptare. GJK ndër vite e ka zgjeruar konceptin e të drejtave të individit dhe së drejtës së tij për t’u ankuar në përputhje me standardet e GJEDNJ-së, duke u përpjekur t’i përshtatet përmbajtjes dhe kërkesave të KEDNJ-së me jurisprudence të saj. Megjithatë në këtë drejtim, ndryshimet e propozuara në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese me rregulla më të plota dhe të qarta, do ta bënin më efektiv GJK si mjet ankimi në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ-së.

Për më tepër, natyrisht linja e jurisprudence së GJEDNJ-së, sa i përket procesit të drejtë gjyqësor, vazhdon të mbetet në vëmendje të GJK, për t’i mundësuar individit venie në vend të drejtave të shkelura, si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes efektive, së pari brenda sistemit kombëtar ligjor.

Ju falenderoj për vëmendjen!